



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS HANI I ELEZIT PËR VITIN 2019

Prishtinë, korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Ajtene Llapashtica*, udhëheqës ekipi dhe *Selvete Foniqi*, *Aurora Morina* anëtarë të ekipit, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Bujar Bajraktari*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	19
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	22
Shtojca II: Letër e Konfirmimit.....	24

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi ynë është fokusuar në:



Konkluzionet

Konkluzioni për Pasqyrat Financiare - Pasqyrat Financiare Vjetore ishin në përputhje me rregullat dhe me Standardet e zbatueshme, me përjashtim të shpalosjeve të informatave tek pasuritë siç është shtjelluar në detaje në nënkapitullin e veçantë të raportit.

Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin - Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat dhe shpenzimet nuk janë në përgjithësi duke u zbatuar në mënyrë efektive për shkak të parregullsive tek menaxhimi i të hyrave, ekzekutimi i pagesave, dhe menaxhimi i pasurive.

Konkluzioni për zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak - Komuna kishte bërë progres të mirë në zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm nga viti paraprak megjithatë duhet vazhduar përpjekjet për implementimin e plotë të rekomandimeve.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Komunës së Hanit të Elezit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq deklarime materiale. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-

deklarim material që mund të ekzistojë. Keq deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat dhe shpenzimet në përgjithësi janë të përshtatshme dhe efektive mirëpo kërkohet ende përmirësim i mëtejshëm për të parandaluar pa rregullsitë. Fushat kryesore ku nevojiten përmirësime janë, zbatimi i rregullave me rastin e planifikimit dhe ekzekutimit të shpenzimeve, menaxhimi i të hyrave. Me tutje, komuna duhet të ndërmarrë veprime për të përmirësuar menaxhimin dhe raportimin e plotë të regjistrave të pasurisë, llogarive të arkëtueshme dhe obligimeve të papaguara.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	2,915,921	3,205,548	3,133,210	98%	2,861,153	2,422,548
Granti i Qeverisë - Buxheti	2,600,555	2,600,554	2,582,110	99%	2,463,145	2,240,415
Të bartura nga viti paraprak ³ -	0	193,189	169,163	88%	138,390	31,440
Të hyrat vetjake ⁴	289,129	289,129	259,569	90%	171,825	113,852
Donacionet e jashtme	0	116,600	116,486	100%	84,970	36,841
Huamarrjet	26,237	6,076	5,882	97%	2,823	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 289,627€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura dhe donacioneve, përderisa kishte zvogëlim të financimit të huamarrjes.

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Në vitin 2019, Komuna ka shpenzuar 98% të buxhetit final ose 3,133,210€, me një rritje në përqindje prej 6% krahasuar me vitin 2018. Realizimi i buxhetit ishte në nivel të kënaqshëm nëpër kategori ekonomike dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	2,915,921	3,205,548	3,133,210	98%	2,861,153	2,422,548
Pagat dhe Mëditjet	1,493,148	1,493,148	1,478,773	99%	1,451,064	1,367,010
Mallrat dhe Shërbimet	263,236	262,142	261,827	100%	226,206	188,215
Shërbimet komunale	54,400	54,400	54,369	100%	44,405	49,932
Subvencionet dhe Transferet	61,104	66,240	66,103	100%	47,659	49,801
Investimet Kapitale	1,044,033	1,329,618	1,272,138	96%	1,091,819	767,590

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti final paga dhe mëditje dhe shërbime komunale nuk kishte pësuar ndryshim në krahasim me buxhetin fillestar;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime kishte pësuar reduktim të buxhetit për 1,094€. Ndryshimet buxhetore ndikoheshin nga fondi i huamarrjes (projekti Shëndetësia Kosovare sipas Marrëveshjes me Ministrinë e Shëndetësisë) dhe zvogëlim të grantit qeveritar për 22,567€, përderisa kishte rritje nga të hyrat e bartura 18,567€, donacionet 500€ dhe nga huamarrja 2,406€⁵.
- Buxheti final për Subvencione kishte rritje nga të hyrat e bartura për 5,136€
- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 285,585€. Prej tyre nga të hyrat e bartura 169,486€, dhe donacionet 116,099€.

⁵ Huamarrja ka të bëjë me marrëveshjen që ka bërë Komuna me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për projektin Reforma në Arsim

Çështja A1 – Keq klasifikimi i shpenzimeve

Gjetja

Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 dhe plani kontabël definojnë qartë se shpenzimet duhet të ndodhin nga kategoritë adekuate ekonomike. Gjithashtu neni 26.1 i LPP përcakton se zyrtari përgjegjës i prokurimit i një autoriteti kontraktues është i vetmi person i autorizuar që të lidh ose të nënshkruajë një kontratë publike në emër të autoritetit të tillë kontraktues. Gjatë procesit të auditimit kemi vërejtur se:

- Nga testimi i pagesave⁶ kemi vërejtur se shpenzimet e varrimit në vlerë 9,690€ si dhe shpenzimet për rehabilitim në vlerë 1,520€ janë paguar dhe regjistruar gabimisht nga mallrat dhe shërbimet, derisa natyra e tyre është subvencion. Përveç kësaj, kontrata e lidhur me spitalin special për reabilitim të përgjithshëm Banja e Kllokotit' për shëbime shëndetësore fizioterapeutike' ishte nënshkruar nga drejtori i departamentit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (pa procedura prokurimi).
- Gjithashtu edhe dy pagesa për vendime gjyqësore për shpenzime të pagave përcjellëse në vlerë prej 1,454€ janë paguar nga kategoria mallra dhe shërbime përderisa shpenzimet i takojnë pagave dhe mëditjeve.

Shkaku i keq klasifikimit të shpenzimeve kryesisht ishte rezultat i keq buxhetimit dhe mungesës së mjeteve në kategoritë adekuate.

Ndikimi

Regjistrimi i shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive të caktuara të shpenzimeve dhe në prezantimin jo të drejtë të shpenzimeve në PFV.

Rekomandimi A1

Kryetari i komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të bëhet ridestnimi i mjeteve kur është e nevojshme) dhe pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate. Blerja e shërbimeve duhet të bëhet përmes procedurave të prokurimit dhe kontratat të nënshkruhen nga menaxheri i prokurimit.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2019 ishin në vlerë 297,254€. Të hyrat kanë të bëjnë kryesisht me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Komuna krahasuar me vitin e kaluar kishte rritje në realizim/përqindje të të hyrave prej 8%.

⁶ 2 pagesa e testuara që lidhen me shërbimet e varrimit në vlerë 3,740€ ndërsa totali i pagesave gjatë vitit për këtë qëllim ishte 9,690€. Për shërbimet reabilitimit ishte vetëm 1 në vlerë 1,520€.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e pranimeve 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat vetanake	289,129	289,129	297,254	103%	288,496	225,193
Të hyrat tatimore	125,409	125,409	117,792	94%	133,801	79,588
Të hyrat jo tatimore	163,720	163,720	179,462	110%	154,695	145,605

Përveç të hyrave të prezantuara në tabelë komuna kishte realizuar edhe të hyra indirekte nga dënimet në trafik në vlerë 24,181€.

Çështja A2 - Mangësi në azhurnimin e të dhënave për tatimin në pronë

Gjetja

Ligji nr. 06/L-005, neni 11.1 përcakton “Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohe zbritja prej pesëmbëdhjetë mijë (15,000) Euro nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit”

- Në dy mostra të testuara në fazën e parë të auditimit kemi vërejtur se nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit nuk ishte bërë zbritja e lejuar për banim primar. Këto raste janë përmirësuar gjatë kohës sa ishim në auditim. Megjithatë nuk është punuar në evidentimin e rasteve tjera ngase gjatë fazës finale të auditimit kemi identifikuar edhe katër tatimpagues tjerë për të cilët nuk është bërë zbritja e banimit primar.
- Në dy mostra për tatim në njësitë rezidenciale të parcelave dhe për tatim për njësi komerciale të parcelave, emërtimi i rrugëve në faturë nuk përputhet me numrin e zonës së vlerësimit sipas raportit mbi vlerësimin e përgjithshëm për komunën, të bërë nga departamenti i tatimit në pronë. Në një rast që fatura i përket vendit Paldenicë me zonë e vlerësimit 3309 me vlerë 30€, e në faturë është përcaktuar me zonë 3310 që i përket rrugës Imer Vila me vlerë 80€). Ndërsa tjetra faturë e cila e ka rrugën Lepenci, kjo rrugë nuk përshkruhet tek zona e vlerësimit, pasi ishte përcaktu me numrin e zonës së vlerësimit 3305 me emërtim tek rruga Dëshmorët e kombit.

Ndikimi Mangësitë e identifikuarra e vështirësojnë kalkulimin e drejtë të tatimit, duke rrezikuar në mbi/nën vlerësim të ngarkesës tatimore.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të siguroj që në bashkëpunim me departamentin e tatimit në pronë në Ministrinë e Financave, të bëj rishikimin e raportit mbi vlerësimin e përgjithshëm të pronave për komunën, në mënyrë që të përfshihen të gjitha emërtimet e rrugëve nëpër zona. Po ashtu duhet të evidentohen dhe korrigjohen gabimet të cilat kanë të bëjnë me të dhënat e tatimpaguesve në sistem, në mënyrë që kalkulimi i tatimit të jetë i saktë.

Çështja A3 - Menaxhim i dobët i pronave publike të dhëna në shfrytëzim

Gjetja Ligji nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 6, pika 1.3 përcakton “Komunat mund të japin në shfrytëzim pronën e paluajtshme për me pak se një (1) vit. Procedurat dhe format për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për periudhën deri në një (1) vit rregullohen dhe përcaktohen me rregullore komunale”

Komuna nuk ka aprovuar rregullore të brendshme për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme komunale. Në vitin 2019 janë nënshkruar 27 kontrata për shfrytëzimin e pronës publike njëvjeçare. Këto kontrata ishin vazhduar duke bërë thirrjen kontraktuesve paraprak për vazhdimin e kontratës, pa procedura për dhënien në shfrytëzim të pronës. Nga 5 mostrat e testuara, kemi gjetur se 4 kontrata⁷ janë nënshkruar edhe pse qiramarrësit nuk kishin kryer obligimet paraprake.

Sipas pohimeve të zyrtarëve këto kontrata janë bartur prej kohës kur komuna ishte nën administrim të komunës së Kaçanikut,⁸ duke vazhduar kontratat e njëjta pa bërë ndonjë ndryshim. Kontratat janë vazhduar pas lidhjes së marrëveshjes së pagesës me këste.

Ndikimi Mungesa e procedurave të shkruara dhe dhënia e pronave në shfrytëzim afatshkurtër pa procedura, dëmton konkurrencën dhe trajtimin e barabartë të të interesuarve. Vazhdimi i kontratave pa i kryer obligimet paraprake rrit rrezikun e mos inkasimit të të hyrave duke i sjell humbje financiare komunës.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të siguroj që procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të përcaktohen dhe aprovohen me rregullore siç parashihet në ligj. Po ashtu para se të nënshkruhen kontratat e reja, të gjithë qiramarrësit/shfrytëzuesit e pronave duhet ti kryejnë obligimet paraprake kontraktuale.

⁷ Në 4 kontratat e testuara kishin borxhe para nënshkrimit të kontratës: M.D kishte borxh 5,994€; Z.B kishte borxh 2,023€; J.K kishte borxh 1,605€; H.A kishte borxh 2,042€.

⁸ Para vitit 2008 këto prona kanë qenë nën menaxhimin e Komunës së Kaçanikut, pasi që në gusht 2008 MAPL e ka certifikuar si komunë Hanin e Elezit.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për pagat dhe mëditjet është 1,493,148€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 224 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 221. Kemi testuar 24 mostra për teste substanciale si dhe 13 mostra për testim të pajtueshmërisë.

Çështja A4 - Mungesa e pozitës së certifikuesit

Gjetja LMFPF, neni 14.1 përcakton që “Çdo organizatë buxhetore, agjenci autonome ekzekutive dhe ndërmarrje publike duhet ta ketë pozitën e Zyrtarit Çertifikues. Zyrtari Çertifikues emërohet dhe i raporton Zyrtarit Kryesor Administrativ”.

Komuna nuk ka të punësuar dhe as të paraqitur në organogram pozitën e Zyrtarit Çertifikues, përkundër që kjo është pozitë kyçe e kërkuar me LMFPF-së. Udhëheqësi për Buxhet dhe Financa është i angazhuar nga ZKA (edhe pse nuk ka ndonjë vendim apo dëshmi të autorizimit), dhe është certifikuar nga thesari për certifikim të pagesave.

Sipas komunës, angazhimi arsyetohet se në atë se nuk kishte staf të mjaftueshëm dhe ZKA kishte angazhuar udhëheqësin për buxhet dhe financa me përgjegjësi shtesë për pozitën e certifikuesit.

Ndikimi Angazhimi shtesë dhe pa autorizim/vendim formal për pozitën e cila është kyçe dhe parashihet me ligj, rrit rrezikun që zyrtarët të hasin në pengesa në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive në raport me kërkesat ligjore.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të inicojë rishikimin e organogramit të komunës për të siguruar se në të është përfshirë edhe pozita e zyrtarit certifikues. Njëherit duhet buxhetuar edhe mjetet financiare për këtë pozitë, në mënyrë që të plotësohen kërkesat ligjore për plotësimin e kësaj pozite.

Çështja A5 – Mangësi në angazhimin e stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta (MShV)

Gjetja Neni 12 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil përcakton që emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj duhet të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” (MShV) për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Komuna gjatë vitit 2019 kishte të angazhuar 19 punonjës me MShV (prej tyre 12 ishin nga vitet paraprake kryesisht nga viti 2017). Për angazhimet e tilla Drejtoria e Arsimit kishte zbatuar procedura të thjeshtuara të rekrutimit, përderisa Drejtoria e Shëndetësisë dhe Administrata nuk i kanë zbatuar këto procedura. Këto angazhime ishin kryesisht për pozita jo specifike të punës⁹, një dukuri e tillë sipas menaxherit të personelit ka ndodhur për shkak të nevojës për angazhimin e stafit shtesë për realizimin e objektivave të komunës.

Ndikimi Shmangia e procedurave të rekrutimit/vazhdimi i pozitave të rregullta të punës me MShV kufizon konkurrencën dhe mund të ndikojë në pozitat e tilla është angazhuar stafi jo meritore.

Rekomandimi A5 Kryetari, duhet të siguroj se MShV përdorën vetëm për punë specifike dhe kontratat nuk zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjor. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që nevojat për pozitat të rregullta të adresohen në Ministri të Financave gjatë planifikimit buxhetor dhe të sigurohet se buxhetohen dhe paguhen nga kategoria e pagave e mëditjeve.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë shërbimet komunale) në vitin 2019 ishte 316,542€, prej tyre ishin shpenzuar 316,196€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me furnizime për zyrë, shpenzimet e derivateve dhe lëndët tjera për ngrohje, shpenzimet komunale, mirëmbajtje të objekteve, shpenzime kontraktuese tjera, etj. Kemi testuar 15 mostra për teste substanciale në vlerë 43,826€ si dhe 6 mostra për teste të pajtueshmërisë.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 66,240€. Prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 66,103€. Subvencionet ndahen për entitete publike dhe jopublike dhe kryesisht janë shpenzuar për të përkrahur sektorin e bujqësisë, kulturës, shëndetësisë, sportit dhe aktivitete tjera në kuadër të Komunës. Kemi testuar 5 mostra për teste substanciale në vlerë 12,100€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

⁹ Pozitat e angazhuara me MSHV ishin Infermier, Arkitekt ne zyrën e Urbanizmit, Punëtor teknik i pylltarisë etj.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në vitin 2019 ishte 1,329,618€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,272,138€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet e realizuara për shtrimin e rrugëve lokale, kanalizim, ujësjellës, shpronësime etj. Kemi testuar 51 mostra për teste substanciale në vlerë 1,021,492€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A6 - Dobësi në procesin e prokurimit

Gjetja Rregullat dhe Udhëzimi Operativ i Prokurimit Publik, neni 20.10 përcakton që “Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara. Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutues”.

Në tri projekte për punë komuna nuk kishte hartuar projektin ekzekutues, por i kishte zhvilluar procedurat e prokurimit vetëm në bazë të paramasës dhe parallogarisë.

Ndikimi Mungesa e projekteve ekzekutuese ndikon në menaxhimin jo të mirë të projekteve, vështirësi në punët në teren dhe në vonesa në realizimin e tyre.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha projektet për punë të përgatiten projektet ekzekutive si pjesë e specifikave teknike të projekteve, në mënyrë që të lehtësohet edhe realizimi i tyre konform kontratave.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e pasurive kapitale e paraqitur në PFV-të e vitit 2019 është 15,490,368€, pasurive jo kapitale 203,250€, dhe stoqe 28,043€. Kemi testuar 92 mostra për teste substanciale në vlerë 1,097,609€. Po ashtu kemi vlerësuar procesin e përgjithshëm të menaxhimit të pasurive, inventarizimin e pasurive dhe mirëmbajtjen e regjistrave të pasurive të komunës.

Çështja B1 - Mangësi në menaxhimin e regjistrave të pasurive dhe shpalosjen e informatave në PFV

Gjetja Rregullorja MF-nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton qartë rregullat dhe procedurat për menaxhimin e pasurive dhe stoqeve. Kjo rregullore kërkon që OB-të të aprovojnë rregulla të brendshme për menaxhimin e pasurive. Po ashtu kjo rregullore përcakton obligimet dhe aktivitetet në lidhje me inventarizimin e pasurive. Gjatë testimit të auditimit kemi evidentuar mangësi në menaxhimin e regjistrave dhe shpalosjen e informatave në PFV, të cilat janë të shpalosura në vijim:

- Komuna nuk kishte aprovuar rregullore apo procedurë të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare ashtu siç kërkohet me rregullën financiare;
- Komuna nuk kishte formuar komisionin për inventarizimin e pasurive;
- Projekti i financuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik që ka të bëjë me Zbatimin e masave të efikasitetit të energjisë në objektet publike në vlerë 66,744€, , ku është investuar në një shkollë, edhe pse është bërë zyrtarisht pranim dorëzimi i pasurive, këto investime/pasuri nuk janë regjistruar në regjistra dhe nuk janë shpalosur në PFV. Megjithatë këto pasuri janë regjistruar me datë 29.06.2020;
- Pagesat për investimet kapitale në vlerë prej 56,900€¹⁰ nuk ishin evidentuar në regjistrat e pasurisë në SIMFK dhe nuk ishin shpalosur në PFV, duke i nënvlerësuar pasuritë kapitale për këtë vlerë;
- Janë identifikuar dobësi edhe gjatë ekzaminimit fizik të pasurive të blera gjatë viteve të mëparshme si: një automobil Toyota që figuron e regjistruar në SIMFK nga viti 2007 me vlerë fillestare dhe bartëse 4,000€, nuk ju kishte llogaritur fare zhvlerësimi. Pajisjet e IT që figurojnë të regjistruara në SIMFK nga viti 2012 me vlerë bartëse 0 (zero), zyrtarët nuk kanë qenë në gjendje të na ofrojnë informata se ku gjenden, andaj ne nuk japim siguri për ekzistencën fizike të tyre;

¹⁰ Shtrimi me kubëza betoni ne zonat urbane vlerë 4,473€; Asfaltimi i trotuarit për këmbësor Hani Elezit - Uji i thartë vlerë 13,997.80€; Ngritja e pllakave përkujtimore për dëshmorët vlerë 6,429.91€; Ndërtimi i rrugëve lokale në vlerë 9,999.29€ dhe Pajisja e kabineteve me mjete mësimore dhe laboratorike vlerë 22,000€.

- Vlera e pasurive nën 1,000€, në PFV është shpalosur sipas raportit të inventarit në përdorim në vlerë 203,250€. Raporti i e-pasurisë (raporti sipas vlerës, ku përfshihet edhe zhvlerësimi) nuk na është siguruar, me arsyen se asnjë blerje nuk është e regjistruar në sistemin e-pasuria në mungesë të qasjes në sistem. Qasjet janë siguruar me datë 13.02.2020.

Këto mangësi kanë ndodhur për shkak të vëmendjes së pamjaftueshme ndaj fushës së menaxhimit të pasurive.

Ndikimi

Mangësitë e identifikuar në menaxhimin e regjistrave të pasurive, kanë ndikuar në shpalosjen jo të saktë të vlerave të pasurive në PFV. Mungesa e procedurave të brendshme dhe mos respektimi i kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive i pamundësojnë menaxhmentit që të ketë në dispozicion informatat e sakta rreth gjendjes së pasurive të komunës dhe kjo e vështirëson marrjen e vendimeve rreth investimeve të mundshme në pasuritë ekzistuese apo vlerësimin e nevojës për investime në pasuri të reja.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të inicoj aprovimin e rregullave të brendshme për menaxhimin e pasurive për të qartësuar secilin aktivitet që lidhet me menaxhimin e pasurive. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë e komunës (përfshirë pasuritë kapitale dhe jo kapitale) janë regjistruar në regjistra dhe janë shpalosur saktë në PFV, në pajtim me kërkesat ligjore.

2.3 Të arkëtueshmet

Në PFV të vitit 2019, komuna ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë 515,267€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 249,195€, taksa e bizneseve 253,121€ dhe qiraja 12,951€.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 42,256€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Krahasuar me vitin 2018 detyrimet e papaguara janë rritur për 20,180€.

2.4.2 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2019, ishte 20,813€. Këto kanë të bëjnë kryesisht me kërkesat për kompensimin e dëmeve si dhe paga jubilarë e përcjellëse sipas marrëveshjes së

përgjithshme kolektive. Krahasuar me vitin paraprak, këto detyrime kanë shënuar rritje për 2,814€.

2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Sipas informatave të ofruara nga Komuna, vlera e detyrimeve kontraktuale në fund të vitit 2019 ishte 495,599€.

2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Komuna nuk ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm pasi që edhe me rregulloren QRK nr 01/2019, Për Themelimin dhe Zbatimin e Funkcionit të Auditimit të Brendshëm në Subjektin e Sektorit Publik, neni 5.2 parashihet që “Subjekti i sektorit publik i cili ka buxhet më pak se 3.000.000€, funksionin e auditimit të brendshëm duhet ta ushtrojë përmes mënyrave tjera¹¹.

Bazuar në rregulloren e lartëcekur (neni 4 pika 1.3), komuna me datë 27.09.2019 kishte bërë kërkesë në Ministrinë e Financave për kryerjen e auditimit të brendshëm për vitin 2019 dhe me datë 11.06.2020 nga njësia e auditimit të brendshëm të MF është pranuar raporti i auditimit me rekomandime për “Funkcionimin e Komunës së Hanit të Elezit”. Komuna kishte përgatitur edhe planin e veprimit për implementimin e katër rekomandimeve të dala nga ky raport.

¹¹ Mënyrat tjera parashihen sipas nenit 4 - Mënyra e zbatimit të funksionit të auditimit të brendshëm, pika 1.2. Njësi e përbashkët e auditimit të brendshëm sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria e Financave; pika 1.3. Nëpërmjet një marrëveshjeje për sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm nga një subjekt i sektorit publik tek një tjetër subjekt me miratimin paraprak të Ministrit të Financave; apo neni 1.4. Nëpërmjet kontraktimit të një kompanie profesionale për kryerjen e auditimit të brendshëm, pas aprovimit të Ministrisë së Financave.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2018 kishte rezultuar në 7 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Komuna kishte dorëzuar në ZKA edhe dy raportet periodike mbi zbatimin e rekomandimeve sipas kërkesave të dala nga rregullorja e punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, 3 rekomandime janë zbatuar; 1 nuk është zbatuar ende, dhe 3 rekomandime janë të mbyllura. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr .	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për ti përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjesh së opinionit të auditimit. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të eliminuar gabimet në shpalosjen e pasurive, regjistrimin e pasurive dhe për ta konfirmuar vlerësimin e saktë të tyre. Gjithashtu Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme	Nuk janë marrë veprime. Rekomandimi në lidhje me theksimin e çështjes nga viti i kaluar është dhënë tek fusha e pasurive.	Rekomandim i mbyllur
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të bëj një vlerësim gjithëpërfshirës të shkaqeve të mosrealizimit të buxhetit në disa kategori të caktuara , si dhe të siguroj një planifikim të drejtë buxhetor krahas projekteve të synuara dhe monitorim të performancës buxhetore në baza të rregullta me qëllim të realizimit të buxheti.	Komuna për vitin 2019 kishte realizim të mirë të buxhetit 98%	Rekomandim i zbatuar
3	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj dhe të merr masa të duhura që brenda një periudhe sa më të shkurtër kohore të inkasoj të gjitha të arkëtueshmet . Gjithashtu duhet të shqyrtohen të gjitha opsionet e mundshme përfshirë edhe	Të hyrat kishin rritje nga viti paraprak për 20,881€, dhe	Rekomandim i zbatuar

		ato ligjore për të siguruar inkasimin e të hyrave të kësaj kategorie, si dhe të krijohet dhe mbahet një evidencë e qartë dhe e kompletuar me të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë që menaxhimi i të hyrave vetjake të jetë më efikas.	komuna ka ndërmarrë veprime me dërgimin e vërejtjeve në fund të 2019.	
4	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Kryetari duhet të siguroj se procesi i regjistrimit të pasurive në regjistrin e pasurive të Komunës duhet të realizohet duke u klasifikuar saktë në kodet ekonomike përkatëse dhe pas kryerjes së këtij procesi, gjendja e pasurive duhet inventarizuar. Pas inventarizimit gjendja e konstatuar duhet të krahasohet me regjistrin e përgjithshëm të pasurive, në mënyrë që diferencat e mundshme të identifikohen dhe më pas të pasqyrohen në regjistrat e pasurive.	Nuk janë marrë veprime.	Rekomandim i pa zbatuar Ref: B1
5	Të arkëtueshmët	Kryetari duhet të ndërmerr masa për të shqyrtuar shkaqet për dështim të inkasimeve të llogarive të arkëtueshme dhe të siguroj mekanizma efektiv për mbledhjen e tyre. Po ashtu, Kryetari duhet të vendos masat e duhura që brenda një periudhë të arsyeshme të inkasoj të gjitha borxhet e prapambetura dhe të inicioj proces të rivlerësimit të llogarive të arkëtueshme, ku të gjitha llogarite do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse dhe mundësive reale për inkasimin e tyre, e në raste të caktuara të bëhet provizionimi apo shlyerja e tyre në rast të kategorizimit si borxhe të këqija.	Komuna ka filluar me procedura duke dërguar vërejtje, duke lidhur marrëveshje, dhe duke dërguar lëndë tek përmbaruesi.	Rekomandim i zbatuar
6	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të siguroj përmbushjen e kërkesës ligjore, respektivisht të rekrutoj një auditor të brendshëm. Nëse kjo kërkesë nuk mund të realizohet, atëherë shërbimi i auditimit të brendshëm, duhet të vazhdojë të kryhet nga Ministria e Financave, apo ndonjë subjekt tjetër publik. Shërbimi i auditimit, do të mbështeste menaxhmentin në vendimmarrje dhe eliminim të dobësive.	Komuna në bazë të QRK-Nr 01/2019 kishte kërkuar auditim në MF, dhe i njëjti ishte realizuar.	Rekomandim i mbyllur
7	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit, procesi i regjistrimit dhe inventarizimit duhet të përfshinë gjithë pasurinë komunale. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele	Raportimi menaxherial nuk është subjekt i trajtimit në këtë raport.	Rekomandim i mbyllur

		të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.		
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të bëhet ridestnimi i mjeteve kur është e nevojshme) dhe pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate. Blerja e shërbimeve duhet të bëhet përmes procedurave të prokurimit dhe kontratat të nënshkruhen nga menaxheri i prokurimit.		
2	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj që në bashkëpunim me departamentin e tatimit në pronë në Ministrinë e Financave, të bëj rishikimin e raportit mbi vlerësimin e përgjithshëm të pronave për komunën, në mënyrë që të përfshihen të gjitha emërtimet e rrugëve nëpër zona. Po ashtu duhet të evidentohen dhe korrigjohen gabimet të cilat kanë të bëjnë me të dhënat e tatimpaguesve në sistem, në mënyrë që kalkulimi i tatimit të jetë i saktë.		
3		Kryetari duhet të siguroj që procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të përcaktohen dhe aprovohen me rregullore siç parashihet në ligj. Po ashtu para se të nënshkruhen kontratat e reja, të gjithë shfrytëzuesit e pronave duhet ti kryejnë obligimet paraprake kontraktuale.		
4	Pagat dhe mëditjes	Kryetari duhet të iniciojë rishikimin e organogramit të komunës për të siguruar se në të është përfshirë edhe pozita e zyrtarit certifikues. Njëherit duhet buxhetuar edhe mjetet financiare për këtë pozitë, në mënyrë që të plotësohen kërkesat ligjore për plotësimin e kësaj pozite.		
5		Kryetari, duhet të siguroj se MShV përdorën vetëm për punë specifike dhe kontratat nuk zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjor. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që nevojat për pozitat të rregullta të adresohen në Ministri të Financave gjatë planifikimit buxhetor dhe të sigurohet se buxhetohen dhe paguhen nga kategoria e pagave e mëditjeve.		
6	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha projektet për punë të përgatiten projektet ekzekutive si pjesë e specifikave teknike të projekteve, në mënyrë që të lehtësohet edhe realizimi i tyre konform kontratave.		
7	Pasuritë	Kryetari duhet të inicioj aprovimin e rregullave të brendshme për menaxhimin e pasurive për të qartësuar secilin aktivitet që lidhet me menaxhimin e pasurive. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë e komunës (përfshirë pasuritë kapitale dhe jo kapitale) janë regjistruar në regjistra dhe janë shpalosur saktë në PFV, në pajtim me kërkesat ligjore.		

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër e Konfirmimit

 DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLICAN QYLLIADA - GOVERNMENT
KOMUNA E ELEZIT - DEŠTINA - HANI I ELEZIT MUNICIPALITY HANI I ELEZIT
Nr. 02/2020-4 Dita: 30.07. 2020
HANI I ELEZIT

**Republika e Kosovës-Republik of Kosova**
Komuna - Municipality
Hani i Elezit

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2019 dhe
për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Hanit të Elezit, për vitin 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Rufki Suma

Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit,
Data: 30 korrik 2020, Hani i Elezit,

